

---

# AKTI I THEMELIMIT e-AudioSafety-Albania

## Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.)

Sot, me date 29/04/2022, e nenshkruara:

a) Znj. Eni Nikolla, shtetase shqiptare, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me NR. ID J059130501, e datelindjes 13-09-1990, lindur ne Tirane dhe rezident ne Tirane, Shqiperi.

Me vullnetin tim te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr, 9901, date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (Ligji i shoqerive) kam vendosur te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "e-AudioSafety-Albania" ("Shoqeria") duke nenshkruar kete Akt Themelimi.

### Neni 1.

#### Emri dhe forma ligjore

- 1.1. Emri i shoqerise eshte "e-AudioSafety-Albania" ("Shoqeria), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "shpk", i cili perfaqeson formen ligjore te saj. Shoqeria do te prezantohet dhe do te zhvilloje aktivitetin e saj duke perdorur emrin "e-AudioSafety-Albania"
- 1.2 Shoqeria eshte entitet ligjor shqiptar dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (Ligji i shoqerive).

### Neni 2.

#### Selia dhe kohezgjatia

- 2.1 Selia e shoqerise ndodhet ne adresen : **Rruga Muhedin Llagani, Pallati Bjorn 2, Kati i 8, Ap 13, Njesia Administrative Nr. 7, Tirane, Shqiperi.** Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise.



---

Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

2.2 Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

**Neni 3.**  
**Objekti i veprimtarise**

3.1. Objekti i veprimtarise te Shoqerise eshte :

- Ofrimin e udhezimeve dhe informacionit te sigurte ne fushen e sigurise ne pune ku perfshihen trajnimi, ofrimi i zgjidhjeve ne fushen e sigurise ne pune, informimi, keshillimi profesional i punemarrësve dhe perfaqësuesve të tyre nepermjet teknologjise.
- Integrimi dhe ofrimi i perdorimit te teknologjise (p.sh.aplikacione, platforma online, faqeweb etj. )
- Dhënia e këshillimit në përdorimin dhe futjen e teknologjive të reja, duke mundësuar informimin sa me te mire dhe ne cdo kohe mbi pasojat e sigurisë dhe shëndetin e punëmarrësve.
- Ofrimin e shërbimeve të jashtme të specializuara per sigurine dhe mbrojtjen në punë, si p.sh. ruajtja ndaj substancave te rrezikshme ne pune, perdorimi i sigurte i paisjeve gjate punes, etj.
- Ofrimi i udhezimeve, informim mbi procedurat e thjeshta te ndihmes se pare ne situata emergjente, evakuimin e sigurt nga vendi i punes ne rast zjarri ose emergjencash te tjera.
- Dhënie e udhëzimeve të duhura mbi dokumentet e detyrueshme te sigurise ne vendin e punes.
- Konsulence teknike dhe kontraktuale, ndaj ndermarrjeve private dhe publike, subjekteve tregtare private dhe publike, apo enteve private dhe publike jo tregtare, duke pasur si qellim final planifikimin dhe realizimin e planeve te zhvillimit dhe/ose ristrukturimin e korporates dhe menaxhimin e planifikimit te burimeve;
- Berja e studimeve, analizave dhe kerkimeve te tregut organizimi i kurseve te trajnimit te dedikuar dhe funksionale per kompanite e mesme te vogla dhe mikro tregetare, te prodhimit dhe te sherbimeve



- 
- Gjithashtu shoqeria mund te ofroje sherbime konsulence apo keshillimi te biznesit sipas legjislacionit ne fuqi.
  - Të gjitha shërbimet e përfshira në këtë objekt te veprimtarise, mund të ofrohen edhe ndërkombëtarisht.

**Neni 4.**  
**Kapitali fillestar dhe ndarja e tij**

- 4.1 Kapitali i Shoqerise eshte ne total 10,000 (dhjetemije) leke, i ndare ne 1 (nje) kuote, plotesisht te nenshkruara nga Ortaket.
- 4.2 Ortaket e shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si me poshte:
- a) **Znj. Eni Nikolla**, shtetase shqiptare, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me NR. ID J059130501, e datelindjes 13-09-1990, lindur ne Tirane dhe rezident ne Tirane, Shqiperi, **i cila zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 10,000 leke e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise.**

**Neni .5**  
**Organet drejtuese dhe Administrimi**

- 5.1 Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj jane si me poshte :
- (i) Asambleja e ortakeve
  - (ii) Administratori
- 5.2 Kompetencat e Asamblese se Otakeve dhe te Administratorit do te percaktohen ne Statutin e shoqerise
- 5.3. **Znj. Eni Nikolla**, shtetase shqiptare, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me NR. ID J059130501, e datelindjes 13-09-1990, lindur ne Tirane dhe rezident ne Tirane, Shqiperi, **per nje afat 5 vjecar.**



---

**Neni 6.**  
**Te tjera**

- 6.1 Cdo çeshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete Akt Themelimi, do te rregullohet nga dispozitat e Statutit te Shoqerise, Ligjit te Shoqerive dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 6.2 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nenshkruhet nga ortakët e Shoqerise, sot me date 29.04.2022 ne kater kopje.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

e-AudioSafety-Albania shpk

Eri Nikolla

